

VENDIM
Nr. 17, datë 29.1.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 407, DATË 17.12.2021, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES ‘PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
BRENDSHËM TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË’, TË KËSHILLIT, I
NDRYSHUAR”**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 164, pika 8, fjalë e fundit, 189, pika 1, germa “ç”, 190, pika 4, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, sipas relacionit nr. 350, datë 29.1.2026, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 407, datë 17.12.2021, “Për miratimin e rregullores ‘Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë’, të Këshillit, i ndryshuar”, bëhen ndryshimet si vijon:

1. Neni 33, ndryshohet si vijon:

“1. Këshilli e ushtron veprimtarinë përmes komisioneve të përhershme, të përkohshme dhe, sipas nevojës, edhe grupeve të punës.

2. Komisionet e përhershme, në përbërje të Këshillit, janë:

a) Komisioni i Planifikimi Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit;

b) Komisioni Disiplinor;

c) Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale;

ç) Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

3. Këshilli mund të vendosë krijimin e Komisioneve të Përkohshme, për trajtimin e çështjeve të veçanta, të cilat nuk përfshihen në kompetencat që u janë caktuar Komisioneve të Përhershme. Vendimi i Këshillit, për ngritjen e një Komisioni, duhet të ketë të paktën:

a) emrin e Komisionit;

b) qëllimin e punës dhe produktet e punës, për t’u përgatitur nga Komisioni;

c) kryetarin e Komisionit;

ç) anëtarët dhe anëtarët zëvendësues të Komisionit, duke ruajtur shumicën për anëtarët prokurorë;

d) datën, kur duhet të raportojë Komisioni, dhe kohëzgjatjen e tij;

dh) mbështetjen me staf për Komisionin;

e) udhëzimet e veçanta për Komisionin.

4. Anëtarët e Këshillit mund të shërbejnë në Komisionet e Përkohshme, në mënyrë vullnetare ose me short.

5. Kur njëri nga komisionet, e vlerëson të nevojshëm, për zgjidhjen e një çështjeje konkrete, ai mund të propozojë krijimin e grupeve të punës. Vendimi për ngritjen e grupit të punës merret nga kryetari i Këshillit dhe përmbush, për sa është e mundur, kërkesat e paragrafit 3 të këtij neni, si dhe cakton:

a) kryetarin e grupit të punës;

b) anëtarin/ët e Komisionit që do të jenë pjesë e grupit të punës,

c) këshilltarët dhe personeli administrativ që do të angazhohet;

ç) udhëzime të detajuara lidhur me detyrën e caktuar;

d) afatin për përmbushjen e detyrave.

6. Nëse Komisioni vlerëson që pjesë e grupit të punës, do të duhet të jenë edhe ekspertë të jashtëm, atëherë ai komunikon dhe merr pëlqimin e kryetarit për të vlerësuar mbulimin e kostove financiare.

7. Komisionet e përhershme dhe të përkohshme, si dhe grupet e punës, mund të miratojnë rregulla më të detajuara për organizimin dhe funksionimin e tyre, për aq kohë sa ato nuk bien ndesh me këtë rregullore ose akte të tjera të Këshillit. Këto rregulla, në çdo rast, i njoftohen Këshillit.”

2. Neni 35, pika 1, ndryshohet si vijon:

“1. Çdo komision i përhershëm përbëhet nga tre anëtarë dhe dy anëtarë zëvendësues. Anëtarët e përhershëm dhe anëtarët zëvendësues të komisioneve të përhershme zgjidhen nga Këshilli. Anëtarësia e komisioneve të përhershme ripërtërihet me anëtarë të rinj çdo 2 vjet e gjysmë, me kusht që anëtari të mos caktohet dy herë në të njëjtin komision.”

3. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot, më 29.1.2026.

KRYETAR
Mirela Bogdani